

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
|---------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Dokumenti ekskluziv - Gjoba 110 mln euro e Arbitrazhit! Shqipëria u rrëzua edhe nga Gjykata e Apelit në Paris! Do i paguajë Becchetit edhe 20 mijë euro shtesë                                                                                                                                                                                                            |
| ADRESA  | <a href="https://www.syri.net/politike/917891/gjoba-110-mln-euro-e-arbitrazhit-shqiperia-u-rrrezua-edhe-nga-gjykata-e-apelit-ne-paris-do-i-paguaje-becchetit-edhe-20-mije-euro-shtese/">https://www.syri.net/politike/917891/gjoba-110-mln-euro-e-arbitrazhit-shqiperia-u-rrrezua-edhe-nga-gjykata-e-apelit-ne-paris-do-i-paguaje-becchetit-edhe-20-mije-euro-shtese/</a> |
| BURIMI  | syri.net                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 19 shtator 2026, 17:35:56 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 17:19:25 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 0d9e8642e70ec3999748d02b835b62bbcf432ec4263431c2304506b1ebc207dc |
| TEKSTI     | 3d1cafe2cd757b5e40f40bdf4e3218110305260ccbb41e972678a49906cc9ad9 |
| PAMJA      | 658e059adbea2fb354e4d28e82b677cf8edb651069c8f85850232eb2f47399f8 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | a5ae9e87f075c8c23175838402a10f3d02ac8e31004528a86b44a21d33fd652a                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | e6de1b535956bbc0d3f1977997734a5d8ef6212b247caf423164a2e3e3b2297a                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a5ae9e87f075c8c23175838402a10f3d02ac8e31004528a86b44a21d33fd652a>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



**ENVER ROBELLI**  
Qëndrimi i Zagrebit dhe  
heshija e Tiranës**NDRIÇIM KULLA**  
Rama dhe Vuçiç, dy vëllezërit  
siamezë të dekadencës  
demokratike evropiane

## më të lexuarat

'Akuza të stisura politikisht', Saiti:  
Dënimi i krerëve të UÇK, jo në emër të  
Kosovës

Specialja: Të akuzuarit vepruan së  
bashku për një qëllim të përbashkët  
kriminal, Thaçi ishte anëtar kyc

Takimi sekret i DEA-s me vendet e  
Amerikës Latine/ Si po i damkos  
shqiptarët narko-shteti i Edi Ramës

By Pass i Elbasanit/ 'Karakaci në rrugën  
e Ballukut', Himci: S'dihet kur do  
përfundojë, tenderat po vidhen

'Thaçi kishte dijeni për krimet, Veseli  
mori pjesë dhe inkurajoi kryerjen e tyre'

Ligji për statusin e magjistratëve të hiqet  
nga rendi i ditës, Bardhi denoncon  
skandalin: Në Kuvend versioni i ri i  
pakonsultuar me asnjë...



## Gjoba 110 mln euro e Arbitrazhit! Shqipëria u rrëzua edhe nga Gjykata e Apelit në Paris! Do i paguajë Becchettit edhe 20 mijë euro shtesë

19:19, 19/09/2026

### ZMADHO TEKSTIN



Kryeministri Edi Rama deklaroi në Kuvend se biznesmeni Francesco Becchetti do të marrë zero lek nga Shqipëria për gjobën që arbitrazhi ndërkombëtar i ka vendosur vendit tonë për mbylljen e 'Agon Channel'. Por pavarësisht këtyre deklaratave, Syri Televizion ka siguruar një vendim të Gjykatës së Apelit në Paris, i cili tregon se vendi ynë mund të mos ketë më rrugë ligjore të zhbërjes së vendimit të arbitrazhit. Sipas dokumentit shteti shqiptar ankimoi jashtë afateve ligjore vendimin e arbitrazhit, duke e bërë të pamundur që ai të zhbëhet.

### SYRI TV

Nga ulësja e tij në Kuvend në orët e para të mëngjesit të së premtes, 18 shtator, Kryeministri Edi Rama konfirmoi se vendimin e arbitrazhit e njeh, por këtë herë, paralajmëroi padi penale jo vetëm për Becchettin por edhe për dy nga gjyqtarët e çështjes.



"Ai sot që flasim, subjekti në fjalë, së bashku me një apo dy arbitrit përkatës do të përballen me drejtësinë i dashur dhe të jesh i sigurt që më herët sesa vonë, të gjitha leket, që të gjitha ato që janë mbajtur padrejtësisht të ngrira, duke ja marrë Albcontrol-it do kthehen në arkën e shtetit shqiptar" deklaroi Rama.

Por pse i bëri këto deklarata Kryeministri i Shqipërisë?


Duket se qeveria ka ezauruar të gjitha rrugët ligjore civile, pasi Gjykatat Ndërkombëtare kanë rrëzuar në çdo shkallë apeli qeverinë në kundërshtimin e gjobës 110 milionë euro që gjykata e Arbitrazhit i ka vendosur Shqipërisë në vitin 2019 për mbylljen e televizionit 'Agon Channel'.

Syri Televizion ka zbuluar ekskluzivisht vendimin e fundit, ku një Gjykatë Apeli në Paris, ka rrëzuar përsëri qeverinë, e cila një vit më parë kërkoi zhbërjen e vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit për gjobën e Becchettit.

Në argumentin e saj, Gjykata e Apelit në Paris, për mungesë kompetence ka rrëzuar padinë e Shqipërisë për zhbërjen e gjobës ndaj Becchettit.

“

"Nga kjo rrjedh se procedura e arbitrazhit në fjalë, ashtu si edhe mosmarrëveshja bazë, nuk kanë asnjë lidhje me Francën dhe se, rrjedhimisht, nuk ekziston asnjë element lidhës që mund t'u japë juridiksion gjykatave të atij Shteti për të shqyrtuar kontestime që u kërkohe të nisin \*ex nihilo\* — në kundërshtim dhe përtej kushteve të Konventës së Uashingtonit, palë e së cilës është Franca dhe të cilën ajo është zotuar ta zbatojë dhe ta respektojë në raport me të gjitha Shtetet e tjera kontraktuese" thuhet në vendim.



Jo vetëm kaq, por gjykata e Apelit në Paris, jep indicie se gjoba ndaj Becchetit do të jetë e pamundur të zhbëhet në rrugë ligjore, për shkak se Shqipëria apeloj tre vjet me vonëse vendimin e arbitrazhit ndaj Becchetit, duke tejkaluar afatet juridike të apelimit.

“

Në këtë drejtim, duhet theksuar se vendimi i datës 29 mars 2023, me të cilin u refuzua kërkesa e parë për rishikim e paraqitur nga Republika e Shqipërisë kundër vendimit arbitral të datës 24 prill 2019, tregon se fakti që kërkesa ishte e vonuar – për shkak të skadimit të afatit trevjeçar të përcaktuar në nenin 51(2) të Konventës së Uashingtonit – ishte ngritur tashmë si argument nga palët kundërshtarë në atë kërkesë.

Ai tregon gjithashtu se Republika e Shqipërisë, duke kontestuar zbatimin e atij afati, nuk pretendoi se ai binte në kundërshtim me të drejtën e qasjes në gjykatë dhe të drejtën për një mjet efektiv juridik sipas neneve 6 dhe 13 të KEDNJ-së; rrjedhimisht, ajo nuk i kërkoj tribunalit arbitral kompetent të kryente shqyrtimin e përputhshmërisë me Konventën, të cilin tani i kërkon kësaj Gjykate ta kryejë në kuadër të një padie për anulim – një lloj procedure për të cilën kjo Gjykatë nuk ka juridiksion.

Në këto kushte, gjykata e Apelit në Paris ka rrëzuar në 26 maj të këtij viti kërkesën e Shqipërisë për shfuqizim të vendimit të arbitrazhit, duke e lënë atë në fuqi.

Në vendimin e pak muajve më parë, Gjykata e Apelit në Paris i ka shtuar edhe 20 mijë euro shtesë gjobës që Shqipëria duhet t'i paguajë Becchetit si dhe një shumë të papërcaktuar financiare, që Shqipëria duhet t'i paguajë avokates Luca De Maria, që është përfshirë në këtë proces.

© SYRI.net

Lexo edhe:



'Dita e 9-të, Ku është kërkesa për Ballukun?' Bardhi: SPAK duhet të zbatojë ligjon jo të presë Edi Ramën



'Jo në emrin tim' - Në Zyrë protestohet kundër vendimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së



Deputeti Himçi: Mosheqja e imunitetit për Belinda Ballukun është dështimi më i madh për reformën në drejtësi

'Vendimi i Hagës, i pabazuar dhe pa fakte', Veseli: Akuzat, të stisura e fabrikua në Serbi

Bardhi - Ramës: Po hakmerresh ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve se të trokitën në derë për aferat ku je zhytur

'Selimi dha kontribut në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal, mori pjesë në kryerjen e krimeve'

TË NGJASHME



Raporti i Eurostat/ Dorian Teliti:  
Gjysma e shqiptarëve nuk përballojnë  
as shpenzimet bazike mujore



Kurti: Është konfirmuar identiteti i tri  
viktimave nga varret masive në Zubin  
Potok, i përkasin 'Grupit të  
Intelektualëve'

KAYO është eksploziv në themelet e  
shtetit



Berisha: Procesi i Ripërtërimit sonë,  
është një proces jetik për Ripërtërimitin  
e Shqipërisë

Kostot e jetesës edhe lajmi se  
ekonomia po ecën mirë



Këllici: Edi Rama, 12 ditë heshtje për  
koordinatorin e punëve të pishëta, Ron  
Yeffet!

Ron Xhepisti

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione [info@syri.net](mailto:info@syri.net), për reklama [marketing@syri.net](mailto:marketing@syri.net)